



## VENDIM

**Nr. 8, Datë 25.06.2012**

### **PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZHVILLIMIN E KONKURISIT PËR POZICIONIN E KANCELARIT NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Këshilli i Administrimit i Universitetit të Arteve në mbledhjen e tij të datës 25.06.2012, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve të anëtarëve,

#### **VËREN SE**

Me Vendimin nr. 7, datë 15.05.2012 Këshilli i Administrimit ka vendosur shpalljen e konkursit për pozicionin e Kancelarit të Universitetit të Arteve, si dhe miratimin e kriterëve për konkurrim. Në vijim të procedurave që lidhen me zhvillimin e konkursit, si dhe pas vlerësimit paraprak të bërë për dosjet e paraqitura nga kandidatët e interesuar, KAdm është i gatshëm vijimin e mëtejshëm të konkurimit, duke vlerësuar kandidatët në bazë të kriterëve dhe duke përcaktuar pikët për secilin kandidat.

Për sa më sipër KAdm miraton procedurat për zhvillimin e konkursit dhe vlerësimit përkatës, duke iu referuar legjislacionit të nëpunësit civil, i cili gjen zbatim në rastin konkret. Për sa më sipër KAdm,

#### **VENDOSI**

1. Këshilli i Administrimit vlerëson kandidatët e paraqitur për konkurrim sipas kriterëve të përcaktuara në Vendimin nr. 7, datë 15.05.2012 të KADM.
2. Pikët maksimale të mundshme për kandidatët janë 100.
3. Kandidati fiton maksimalisht 70 pikë nga vlerësimi i dosjes, në përputhje me vlerësimin e bërë nga KAdm sipas pikëve për kriteret e përcaktuara, në përputhje me shpjegimet në Lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Kandidati fiton maksimalisht 30 pikë nga vlerësimi gjatë testimit me gojë, që bën KAdm.
5. Këshilli i Administrimit gjatë zhvillimit të procedurave të konkurimit plotëson formularët e përcaktuar në Lidhjet 2, 3 dh 4 bashkëlidhur këtij vendimi.



6. Në përfundim të vlerësimit, Këshilli i Administrimit merr vendim për shpalljen e klasifikimit dhe kandidatit fitues.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KËSHILLI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

## Lidhja 1

### Vlerësimi për pozicionin e punës KANCELAR NË UART për kandidatin:

---

#### Anëtari i Këshillit të Administrimit \_\_\_\_\_

Këshilli i Administrimit i UART pasi është njohur me listën e konkurrentëve të përzgjedhur gjatë fazës së parë së paraqitjes së dokumenteve nga kandidatë të interesuar ka filluar vlerësimin e secilës kandidaturë, në përputhje me Njoftimin për shpallje konkursi nr. 663 prot., date 17.05.2012 që ka dërguar UART në Agjencinë e Prokurimit Publik (botim në Buletinin e Njoftimeve Publike) si dhe duke iu referuar kriterëve sipas skemës së vlerësimit të kandidatëve, duke përshkruar me hollësi mënyrën e vlerësimit të kandidatëve, në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", siç përcakton pika 2, germa C e VKM nr. 875, datë 18.06.2008 "Për përcaktimin e të drejtave e të detyrave dhe për procedurën e përzgjedhjes e të emërimit të kancelarit të institucioneve publike të arsimit të lartë".

Sipas pikës 17 të VKM nr. 231, date 11.05.2000 "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës", i ndryshuar, shpërndarja e pikëve bëhet si vijon:

*Piket maksimale të mundshme janë:*

*1. 70 pikë ne rezultatin e testimit të dosjes; të ndara si më poshtë*

-	<i>Përvoja në punë në profil (jo me pak se % vjet)</i>	<i>10 pikë</i>
-	<i>Rekomandimi nga punëdhënësi i fundit</i>	<i>15 pikë</i>
-	<i>Dëshmia e gjuhës së huaj</i>	<i>5 pikë</i>
-	<i>Përvoja në Arsimin e lartë</i>	<i>10 pikë</i>
-	<i>Dëshmia e kompjuterit</i>	<i>9 pikë</i>
-	<i>Kualifikime trajnime</i>	<i>5 pikë</i>
-	<i>Aftësitë e mira drejtuese dhe menaxhuese—.</i>	<i>11 pikë</i>
-	<i>Vjetërsia gjithsej</i>	<i>5 pikë</i>

## 2. testimi me goje

30 pikë

\*\*\*\*\*

Nisur nga sa më sipër, si dhe pasi kam shqyrtuar dokumentacionin e kandidatit, kam arritur në përfundimin se vlerësimi lidhur me plotësimin e kriterëve nga ana e kandidatit duhet të jetë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Kriteri	Vlerësimi narrativ	Pikët e fituara nga totali	
1	<i>rezultatin e testimit</i>			nga 70
2	<i>përvojën në punë të kandidatit</i>			nga 10
2	<i>kualifikimet</i>			nga 8
3	<i>publikimet shkencore</i>			nga 8

4	<i>aftësitë personale të veçanta</i>			nga 4
<b>GJITHSEJ</b>				<b>nga 100</b>

Anëtari i KAdm \_\_\_\_\_

V.o:

Kriteri Nr. 1 (**rezultati i testimit**), sipas pikës shënuar me ngjyrë në VKM bashkangjitur, do të thotë: vlerësimi profesional sipas kriterit që ne kemi shpallur për konkursin dmth. Pikave; 3, 5 dhe 7.

Kriteri Nr. 2 (**përvojën në punë të kandidatit**), është vlerësimi sipas kriterit tonë të pikës 9. (me koefiçent)

Kriteri Nr. 3 (**kualifikime**), është kualifikime kompjuterike, profesionale me baze ekonomike etj, sipas pikës 8 të kriterëve.

Kriteri Nr. 4 (**Publikime shkencore**) , .....

Kriteri Nr. 5 (**aftësi të veçanta profesionale**), është psh. Vlerësimi që është bërë nga punëdhënësi i fundit, ose nga audituesit e autoriteteve superiore, në periudhën e punës (*kur ky auditim ka si qëllim kontrollin e drejtpërdrejtë të kandidatit*). Duhet të mbështetemi tek jetëshkrimi i kandidatit (CV).



Lidhja 2

## PROÇES - VERBAL

Për verifikimin e prezencës gjatë zhvillimit të konkurimit për pozicionin

### KANCELAR NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2012, në orën \_\_\_\_\_, Kadm UART i mbledhur për zhvillimin e konkurimit për pozicionin e mësipërm, pas verifikimit të dokumentave të identitetit, konstatoi se janë paraqitur për zhvillimin e testimit kandidatët e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

#### ANETARET E KESHILLIT TE ADMINISTRIMIT

- |          |         |
|----------|---------|
| 1. _____ | Kryetar |
| 2. _____ | Anëtar  |
| 3. _____ | Anëtar  |
| 4. _____ | Anëtar  |
| 5. _____ | Anëtar  |
| 6. _____ | Anëtar  |
| 7. _____ | Anëtar  |



Lidhja 3

## DEKLARATË PËR VLRËSIMIN E PAANSHËRISË SË ANËTARËVE TË KADM UART

Ne anëtarët Këshilli i Administrimit të UART, për të marrë në testim kandidatët e paraqitur për pozicionin e **KANCELAR NË UART** Deklarojmë se nuk gjendemi në asnjë nga rastet e paraqitura në neni 37, i Kodit të Proçedurave Administrative me konkurentët e paraqitur në testim. Deklarojmë se u njohëm me emrat e konkurentëve dhe dispozitat ligjore bashkëlidhur.

### ANETARET E KESHILLIT TE ADMINISTRIMIT

- |          |         |
|----------|---------|
| 1. _____ | Kryetar |
| 2. _____ | Anëtar  |
| 3. _____ | Anëtar  |
| 4. _____ | Anëtar  |
| 5. _____ | Anëtar  |
| 6. _____ | Anëtar  |
| 7. _____ | Anëtar  |

Tiranë, më \_\_\_\_\_



#### Lidhja 4

## PROÇES - VERBAL

I vlerësimit të kandidatëve gjatë testimit me dosje dhe me gojë.

Për pozicionin **KANCELAR NË UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Emër Mbiemër	Vlerësimi i Këshillit të Administrimit <b>30 pikë</b>	Vlerësimi i dosjes nga KT <b>70 pikë</b>	Total Pikë <b>100 pikë</b>





Lidhja 5

## PROÇES - VERBAL

I renditjes me pikë të kandidatëve në përfundim të testin

Për pozicionin

### KANCELAR NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në përfundim të testimit kandidatët pjesmarrës renditen si më poshtë:

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_

### ANETARET E KESHILLIT TE ADMINISTRIMIT

- |          |         |
|----------|---------|
| 1. _____ | Kryetar |
| 2. _____ | Anëtar  |
| 3. _____ | Anëtar  |
| 4. _____ | Anëtar  |
| 5. _____ | Anëtar  |
| 6. _____ | Anëtar  |
| 7. _____ | Anëtar  |